



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 42, datë 29.04.2020

**“PËR
MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT
TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 44, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 51, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit plotësues nr.1 datë 17.01.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit 2019”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2019, sipas pasqyrave bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të gjitha institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI



0.76
20.05.20




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 694/ Prot.

Tiranë më 13.5.2020

Lënda: Verifikim ligjshmërie



KËSHILLIT BASHKIAK TIRANË

Tiranë

Bazuar në Ligjin nr.107/2016, dt.27.10.2016 « Për Prefektin » dhe Ligjin nr. 139/2015 «Për vetëqeverisjen vendore », Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e Vendimeve nr. 40-46, datë 29.4.2020 të Këshillit të Bashkisë Tiranë.

Për sa më sipër:

1. Vendimi nr.40, Dt. 29.4.2020 “Për miratimin e pagesës së qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, për familjet evakuara nga banesa e tyre të dëmtura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019” është në përputhje me Ligjin nr.96/2019 “Për miratimin e aktit normative me fuqinë e ligjit nr.8, dt.16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvecionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e tërmetit të dt.26.11.2019”.
2. Vendimi nr. 41, Dt. 29.04. 2020 “Për krijimin e shërbimit vullnetar për mbrojtjen dhe shërbimin nga zjarri” është në përputhje me “Për shërbimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me Ligjin nr.45/2016 “Për vullnetarizmin”. Për zbatimin e pikës 7 të këtij vendimi të zbatohet pika 2 e nenit 4 të Ligjit nr.45/2016 “Për vullnetarizmin”.
3. Vendimi nr. 42, Dt. 29.04.2020 “Për miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2019” është në përputhje me Ligjin nr.68/2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”.
4. Vendimi nr.43, Dt.29.04.2020 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë , të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK**

funkcionale në realizimin e programeve arsimore “ është në përputhje me Ligjin nr.8744, DT.22.02.2001 2020 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e vetqeverisjes vendore”.

5. Vendimi nr.44, Dt.29.04.2020 “Një ndryshim në vendimin nr.108, dt.25.10.2019 të këshillit Bashkiak” është në përputhje me Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjes vendore” dhe ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

6. Vendimi nr.45, Dt.29.04.2020 “Nisjen e procedurave të bashkimit me përthithje të shoqërisë “Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.3 sh.a nga shoqëria përthithëse “Rezidenca studentore unversitare nr.1 sh.a Tiranë” është në përputhje me Ligjin nr.9901, dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare”, të ndryshuar.

7. Vendimi nr.46, Dt.29.04.2020 “Për disa ndryshime në VKB nr.157, dt.26.12.2019 “për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 202, të ndryshuar” është në përputhje me Ligjin nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
SUZANA JAHOLLARI